



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria-Vlada-Government*



Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute of Public Health of Kosova

---

## **BULETINI MUJOR I SËMUNDJEVE NGJITËSE**

**Gusht, 2025**

## PËRMBAJTJA E BULETINIT

1. Rastet e sëmundjeve ngjitëse gjatë muajit gusht 2025
2. Sëmundjet e raportuara në Kosovë, sipas komunave
3. Rastet e spitalizuara nga sëmundjet ngjitëse
4. Epidemitë e lajmëruara
5. Niveli i raportimit nga institucionet shëndetësore
6. COVID-19
7. Situata epidemiologjike në rajon dhe botë

### QËLLIMI:

Që të përcillet dhe vlerësohet situata epidemiologjike me sëmundje ngjitëse në Kosovë, trendin e sëmundjeve ngjitëse, momentet me valide epidemiologjike, shkallën dhe kualitetin e raportimit të institucioneve shëndetësore me qëllim të përforcimit të parandalimit dhe përgjigjes epidemiologjike.

### 1. NUMRI I RASTEVE DHE VDEKJEVE NGA SËMUNDJET NGJITËSE GJATË MUAJIT GUSHT 2025

Gjatë muajit gusht 2025 janë raportuar **23,254 raste** me sëmundje ngjitëse **Inc.(1304.85 raste /100, 000 banorë)**. Ky numër i rasteve është më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit **2024 (45,301 raste apo Inc 2,541.98 raste/100,000)**. Sëmundjet të cilat prijnë me numër më të lartë të rasteve janë: **Diare ac. me 16,790 raste ose 942.14/100,000 Influenca sezonale (ILI) me 4,954 raste ose 277.98/100,000 banorë**, banorë, dhe **ARI/ITPR me 609 raste ose 34.17 në 100,000 banorë (Tab.1)**.

Gjatë muajit gusht 2025 janë raportuar 5 raste të vdekjes nga sëmundjet ngjitëse: 4 raste me dg. Infiltratio pulmonum me diagnozë përcjellëse dhe 1 rast me dg. Meningoencephalitis ac. me diagnozë përcjellëse

**Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse/shkaktarëve të raportuar në Kosovë, 01 – 31 gusht të vitit 2024 dhe 2025**

Tabela 1.

Numri i rasteve dhe incidenca e disa sëmundjeve ngjitëse në Kosovë  
në perludhën 01 - 31 gusht të vitit 2024 dhe 2025

Sëmundjet	Gusht, 2024		Gusht, 2025	
	Nr.	Incidenca/ 100.000	Nr.	Incidenca/100.000
COVID-19	1416	79.46	39	2.19
ITPR - Pneumonia/ARI	1109	62.23	609	34.17
SARI (forma e rëndë e pneumonisë)	32	1.80	22	1.23
Sëmundje e ngjashme me gripin (ILI)	13028	731.04	4954	277.98
RSV			1	0.06
Diarea acute	28726	1611.90	16790	942.14
Variçela	274	15.37	180	10.10
Sindromi meningjeal	11	0.62	16	0.90
Helmimet me ushqim	320	17.96	294	16.50
Infeksionet virale, infeksionet specifike intestinale me Rotavirus	21	1.18	27	1.52
Salmonella enteritidis	7	0.39	11	0.62
Adenovirus	3	0.17	12	0.67
Gastroenterokolitet	70	3.93	114	6.40
Clostridium difficile	3	0.17	2	0.11
E.coli				0.00
Hepatit akut A		0.00		0.00
Hepatiti akut B	3	0.17	1	0.06
Hepatiti akut C		0.00	1	0.06
Morbill			5	0.28
Pertussis	15	0.84	2	0.11
Brucelosis	6	0.34	4	0.22
Tularemi		0.00	1	0.06
Toxoplasmosis		0.00	1	0.06
WNV	3	0.17		0.00
Sëmundja Lyme	3	0.17	3	0.17
Leishmaniaza			1	0.06
Malarie	2			0.00
HIV/AIDS	1	0.06	3	0.17
TB	**163	9.15	25	1.40
IST	48	2.69	29	1.63
Enterovirus	6	0.34	5	0.28
Giardiaza	2	0.11	8	0.45
Infeksioni streptokoksik i grupit A			12	
Entameba hystolitica	1	0.06	1	0.06
*Sëmundjet tjera ngjitëse	27	1.52	81	4.55
<b>Gjithsej</b>	<b>45301</b>	<b>2541.98</b>	<b>23254</b>	<b>1304.85</b>

\*Sëmundjet tjera ngjitëse: Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza

\*\*TB-janar-shtator 2024

## 1. SËMUNDJET NGJITËSE TË RAPORTUARA NË KOSOVË, GUSHT 2025

### Grupi i sëmundjeve që raportohen me formën e agreguar:

**Diarea akute:** Gjatë muajit gusht 2025 në IKSHPK janë raportuar 16,790 raste me sindromë diareale (Inc.942.14/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (28,726 raste), vërehet një ulje prej mbi 41.55% por krahasuar krahasuar me muajin korrik 2025, me 11,126 raste të raportuara, rritje prej 50.9% e rasteve të raportuara, numër ky i konsideruar i rasteve të raportuara i cili mbetet shqetësim për shëndetin publik, pasojë kjo e ekspozimit ndaj patogjenëve të ndryshëm në ushqim dhe ujë gjatë kësaj periudhe të vitit.

**Influenca sezonale /ILI:** Gjatë muajit gusht 2025 në IKSHPK janë raportuar 4,954 raste me ILI (Inc. 277.98/100,000 banorë). Sipas numrit të rasteve të raportuara vërehet rënie prej 61.98% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak me (13,028 raste) por krahasuar me muajin paraprak, korrik 2025 me ( 4,121 raste të raportuara me ILI) vërehet rritje prej 20.2%, karakteristikë kjo për rritje të qarkullimit të patogjenëve respirator si rrjedhojë e faktorëve si: qarkullimi i viruseve respiratore edhe jashtë sezonit (p.sh. adenoviruse, rinoviruse, SARS-CoV-2), grumbullimeve masive gjatë pushimeve verore, rritjes së lëvizjeve (turizmi, migracioni ).

**ARI/ITPR:** Gjatë muajit gusht 2025 në IKSHPK janë raportuar 609 raste me ARI (Inc.34.17/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (858 raste) vërehet ulje prej 16.9% e numrit të rasteve të raportuara dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak korrik 2025 me (713 raste), ulje prej 16.01%. 713

**Variçella:** Gjatë muajit gusht 2025 në IKSHPK janë raportuar 180 raste me Variçellë (Inc.10.1/100,000 banorë) dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 me (274 raste) vërehet ulje prej 34.3% e rasteve të raportuara dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak korrik 2025 me 404 raste të raportuara, ulje prej 55.4%.

## **Grupi i sëmundjeve që raportohen me formën individuale:**

### **Sëmundjet vaksinëparandaluese**

Gjatë muajit gusht 2025, janë raportuar 8 raste të dyshimta me fruth ku 5 prej tyre janë konfirmuar me laborator si raste pozitive. Të gjitha rastet pozitive janë raste kontakti dhe tregues për përhapje në komunitet. Sipas komunave: Gjakovë (3 raste) dhe Prishtinë (2 raste), të pavaksinuara me vaksinën MMR. Sipas gjinisë: 3 raste i përkasin gjinisë femërore dhe 2 raste gjinisë mashkullore. Sipas grup-moshës: mbi 6 vjeç; (3 raste), që përbëjnë 60% të rasteve dhe grup-moshat 0-1 vjeç dhe 3-5 vjeç; (me nga 1 rast) apo 20%.

Gjate muajit gusht 2025, nga laborator i mikrobiologjik i IKShPK-së, gjithashtu janë konfirmuar 2 raste pozitive me Pertussis. Rastet e konfirmuara sipas komunave: Prishtinë dhe Fushë Kosovë me nga 1 rast. Sipas grup-moshës rastet i takojnë asj mbi 6 vjeç dhe nuk kanë status të rregullt vaksinal.

### **Zoonozat dhe sëmundjet transmissive:**

Gjatë muajit gusht 2025, nga ky grup i sëmundjeve janë raportuar 4 raste me Brucellozë dhe me nga 1 rast, zoonozat tjera: Tularemi dhe Toxoplazmozë. Sipas komunave rastet me Brucellozë: Prizren (2 raste), dhe me nga një rast komunat: Prishtinë dhe Pejë. Nga anketimi epidemiologjik rezulton se rastet janë raste sporadike, pa ndonjë lidhshmëri epidemiologjike. Shpërndarja e rasteve sipas grup-moshës: me nga një rast raportohen grup moshat: 0-9, 30-39, 40-49 dhe 50-59 vjeç e sipas gjinisë 2 meshkuj dhe 2 femra.

Rasti me Tularemi është nga komuna e Fushë Kosovës, grup moshë 30-39 vjeç e gjinisë femër dhe mohon kontaktin me brejtës ndërsa rasti me Toxoplazmozë nga komuna e Vitisë, i grup moshës 40-49 vjeç i gjinisë mashkull.

Sëmundjet që barten përmes vektorëve:

Gjatë muajit gusht janë raportuar 3 raste me Borreliozë, prej të cilave të 3 rastet nga komuna e Prishtinës. Sipas grup moshës të tre rastet janë të grup moshës 50-59 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë të tre rastet janë të gjinisë femërore si dhe 1 rast me Leishmaniazë, nga komuna e Rahovecit. Rasti i takon gjinisë mashkullore dhe grup moshës 60-69 vjeç.

### **Sindroma meningjeale:**

Gjatë muajit gusht, 2025 janë raportuar 16 raste me Sindromë Meningjeale (Mb. 0.89/100 000 banorë), prej tyre 15 raste me Meningjit akut viral dhe 1 rast me Meningjit purulent. Ky numër i rasteve të raportuara është më i lartë krahasuar me periudhën e vitit 2024, ku ishin të raportuara gjithsej 11 raste (3 raste me Meningoencephalitis acuta dhe 8 raste me Meningitis acuta serosa). Sipas komunave, me nga 3 raste janë raportuar në komunën Prishtinës dhe Ferizajit, 2 raste në komunën e Mitrovicës dhe me nga 1 rast komunat: Gjakovë, Pejë, Drenas, Kaçanik, Obiliq, Rahovec, Viti dhe Graçanicë kurse Incidenca më e lartë e rasteve në 100,000 banorë është raportuar nga komuna e Graçanicës me 4.9/100,000 banorë. Sa i përket grup- moshës, gjatë kësaj periudhe, rezulton se numri më i madh i rasteve i takon grup- moshës 0-9 vjeç me 31.2% (5 raste), grup moshë 10-19 vjeç dhe 60-69 vjeç dhe 70-79 vjeç, me 18.75% (3 raste), kurse grup moshat 20-29 vjeç, 30-39 vjeç dhe 50-59 vjeç me nga 1 një rast të raportuar (6.25%). Sipas gjinisë, rezulton se 62.5 % (10 raste) i takojnë gjinisë mashkullore dhe 37.5 % (6 raste) të gjinisë femërore.

Nga mostrat humane të testuara në laboratorët e Mikrobiologjisë në IKShPK dhe laboratorin mikrobiologjik në Klinikën Infektive, janë izoluar 7 shkaktarë në LCS, prej tyre: me nga 2 raste Varicela Zoster Virus dhe Epstein Barr Virus, dhe me nga 1 rast me HHV7, Human Enterovirus dhe Human parvovirus B19.

Nga 16 rastet e raportuara me Sindromë Meningjeale, prej tyre është raportuar 1 rast i vdekjes me dg. Meningoencephalitis ac, 64 vjeç, i gjinisë mashkullore nga Graçanica me dg. përcjellëse si: Insufficienca respiratoria, Infiltratio pulmonum bill dhe Fibrosis pulmonum chr.

## **Sëmundjet që barten me ujë dhe ushqim:**

Gjatë muajit gusht 2025, përmes SMSN nga të gjitha regjionet janë raportuar gjithsej 4,714 raste të sëmundjeve që barten me ujë dhe ushqim, prej të cilave: 4,347 raste me dg. Diarea dhe gastroenteritet me origjinë infektive të supozuar (AO9); 195 raste me dg. Intoksikacionet tjera bakteriale alimentare (AO5); 74 raste me dg. Infeksionet virale dhe infeksionet tjera specifike intestinale me (AO8.0); 72 raste me dg. Infeksionet tjera intestinale bakteriale me shkaktarë të paspecifikuar (AO4.8); 20 raste me dg. Intoksikacion bakterial me ushqim, i paspecifikuar (AO5.9); 4 raste me dg. Salmonella (Salmonella spp.) (AO2.0); dhe nga 1 rast me dg. Intoksikacion stafilokokcik me ushqim (AO5.0) dhe dg. Infeksione tjera intestinale, të specifikuar (AO8.5).

Sipas shkaktarëve të izoluar në Laboratorin e Mikrobiologjisë në IKSHPK dhe Kl. Infektive, janë raportuar:

27 raste me Rotavirus prej të cilave sipas komunave janë: 21 raste Prishtinë, 2 raste Gjakovë, dhe nga 1 rast Lipjan, Fushë Kosovë, Mitrovicë dhe Podujevë. Sipas grup moshave: 24 raste janë të grup moshës 0-9 vjeç, 2 raste të grup-moshës 60-69 vjeç dhe 1 rast i grup moshës 80+ vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 15 raste janë të gjinisë mashkullore dhe 9 raste të gjinisë femërore.

12 raste me Adenovirus, prej të cilave sipas komunave janë: 6 raste Mitrovicë, 3 raste Prishtinë dhe nga 1 rast Gjakovë, Rahovec dhe Vushtrri. Sipas grup moshave: 11 raste janë të grup moshës 0-9 vjeç dhe 1 rast i grup moshës 10-19 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 6 raste të gjinisë mashkullore dhe 6 raste të gjinisë femërore.

11 raste me Salmonela Enteritidis prej të cilave sipas komunave janë: 5 raste Prishtinë, 2 raste Ferizaj dhe nga 1 rast Lipjan, Vushtrri, Podujevë, Malishevë. Sipas grup moshave: nga 3 raste janë të grup moshave 10-19 vjeç dhe 40-49 vjeç, nga 2 raste të grup moshave 0-9 vjeç, 20-29 vjeç dhe 1 rast i grup moshës 30-39 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 7 raste janë të gjinisë mashkullore dhe 4 raste të gjinisë femërore.

48 raste me Giardia lamblia, prej të cilave sipas komunave janë: 2 raste Mitrovicë, 2 raste Lipjan dhe nga 1 rast Prizren, Pejë, Istog dhe Podujevë. Sipas grup moshave: 5 raste janë të grup moshës 0-9 vjeç dhe nga 1 rast i grup moshave 10-19 vjeç, 30-39 vjeç dhe 40-49 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 4 raste të gjinisë mashkullore dhe 4 raste të gjinisë femërore.

5 raste me Enterovirus, prej të cilave sipas komunave janë: 5 raste Prishtinë. Sipas grup moshave të 5 rastet janë të grup moshës 0-9 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë 1 rast i gjinisë mashkullore dhe 4 raste të gjinisë femërore.

62 raste me Clostridium difficile, prej të cilave sipas komunave janë: 2 raste Prishtinë. Sipas grup moshave nga 1 rast i takon grup moshave 20-29 vjeç dhe 30-39 vjeç. Ndërkaq sipas gjinisë të 2 rastet janë të gjinisë mashkullore.

1 rast me Entamoeba Histolytica, nga komuna e Fushë Kosovës. Rasti i takon gjinisë mashkullore dhe grup moshës 50-59 vjeç.

1 rast me Enterobius vermicularis, nga komuna e Pejës. Rasti i takon gjinisë femërore dhe grup moshës 60-69 vjeç.

## **Sëmundjet/Infeksionet respiratore**

Gjatë muajit gusht 2025, nga qendrat sentinel janë testuar 196 mostra të dyshimta në Influcencë dhe patogjenët tjerë respirator dhe 204 mostra të dyshimta në SARS CoV-2.

Nga mostrat e testuara nuk është konfirmuar asnjë rast pozitiv me Influcencë A dhe B ndërsa nga patogjenët tjerë respirator janë konfirmuar 26 mostra pozitive me Human Adenovirus (ADV) apo 13.26%, 18 mostra pozitive me Human Rhinovirus (HRV) apo 9.18%, 8 mostra pozitive me Parainfluenza Virus (PIV) apo 4.1 % dhe 1 mostër pozitive në virusin sincial (RSV) apo 0.6%. Rasti me RSV i përket komunës së Mitrovicës dhe i takon grup-moshës 0-4 vjeç, me sëmundje përcjellëse.

Mbikëqyrja me Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë vazhdon sipas rekomandimeve të ECDC dhe OBSH për Influcencë me të dhënat e përditësuara nga mbikëqyrja epidemiologjike dhe virologjike. Duke pasur parasysh mungesën e sezonalitetit të parashikueshëm të SARS-CoV-2 dhe potencialin për rritje të aktivitetit, mbikëqyrja aktive duhet të vazhdojë gjatë gjithë vitit, në përputhje me udhëzimet e ECDC dhe OBSH. Intensiteti i Influcencës sezonale për muajin gusht 2025 paraqitet në

nivel të ulët të aktivitetit të qarkullimit. Gjatë këtij muaji nuk është raportuar asnjë rast pozitiv. Ky nivel i ulët i qarkullimit është në përputhje me tendencën sezonale të kësaj periudhe të vitit. Gjatë muajit gusht 2025, përmes raportimit nga Kl. Infektive dhe Sistemit të Mbikqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse (SMSN), u raportuan janë raportuar gjithsej 22 raste me SARI (Inc. 1.23/100,000 banorë) dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 me (32 raste) vërehet rënie e numrit të rasteve prej 31.3% dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak (14 raste), rritje prej 57.1%.

Të gjitha rastet, sipas protokollit dhe kërkesave të klinikistit, u testuan së paku në tre viruse respiratore, SARS-CoV-2, Influcençë dhe RSV. Prej tyre rezultuan 2 mostra pozitive në SARS-CoV-2, 1 mostër pozitive në Virusin Sincicial (RSV), 6 mostra pozitive në Human Adenovirus (ADV), 2 mostra pozitive në Parainfluenca Virus (PIV) dhe 2 mostra pozitive në Human Rhinovirus (HRV).

Rastet SARI sipas komunave janë: Prishtinë (5 raste), Vushtrri (2 raste), Lipjan (2 raste), Glllogoc (2 raste) dhe me nga një rast komunat Ferizaj, Malishevë dhe Skenderaj.

Numri më i lartë i rasteve SARI sipas grup moshës është : 0-4 (17 raste), 15-34 (1 rast), 35-50 (1 rast), 51-64 (1 rast) dhe mbi 65 vjeç (2 raste). Sipas gjinisë, 14 prej tyre i takojnë gjinisë mashkullore dhe 8 gjinisë femërore. Gjatë muajit gusht 2025, janë raportuar dy raste të vdekjes me SARI (CFR=9.1). Rastet e vdekjes i takojnë komunave : Prishtinë (1 rast) dhe Malishevë (1 rast), gjinisë mashkullore, grup-moshave 15-34 (1 rast) dhe 65+ (1 rast), me sëmundje shoqëruese.

Nga të gjitha rastet e raportuara SARI, në Klinikën Pediatrike u hospitalizuan 16 raste, ndërsa në Klinikën Infektive 6 raste, ku 3 prej tyre u pranuan në Njësine e Mjekimit Intensiv.

Në SMSN, gjatë muajit gusht 2025, janë raportuar 25 raste me Tuberkuloz apo 1.4 në 100,000 banorë. Sipas komunave: Prishtinë (13 raste), Lipjan (4 raste), Gjilan dhe Ferizaj me nga (3 raste) dhe Peja me (2 raste). Prej 25 rasteve të raportuara, 20 (80%) janë raste pulmonare dhe forma ekstrapulmonare 5 (20 %). Nga forma pulmonare, të konfirmuara bakteriologjikisht janë 13 raste (65%). Sa i përket grup- moshës, gjatë kësaj periudhe, rezulton se grup- moshë më e prekur është ajo 60-69 vjeç me 12 raste apo (48%), 30-39 vjeç me 5 raste (20%), grup moshë 40-49 vjeç me 4 raste (16%), 50-59 vjeç me 2 raste apo (8%), kurse grup moshë 15-19 vjeç dhe 20-29 vjeç me nga 1 rast (4%). Sipas gjinisë, rezulton se gjinia femërore me 52% (13 raste) kurse 48 % (12 raste) i takojnë gjinisë mashkullore.

### **Rastet me HIV/AIDS/IST, gusht 2025**

Gjatë muajit gusht 2025, janë raportuar 3 raste me HIV. Rasti i parë është i gjinisë mashkullore, grup moshë 35-44 vjeç, popullata kyçe MSM, komuna e Vushtrrisë. Raportuar në SMSN/Klinika Infektive. Rasti i dytë është i gjinisë femërore, grup moshë 35-44 vjeç, komuna Fushë Kosovë. Raportuar në SMSN/Klinika Infektive.

Rasti i tretë: mostra e dërguar për konfirmim nga ana e QKTGj, nuk ka të dhëna për moshë, gjini, vendbanim si dhe nuk është e raportuar në SMSN.

### **Ecuria e Infeksioneve Seksualisht të Transmetueshme (IST), gusht 2025**

Gjatë muajit gusht 2025 janë raportuar gjithsej 29 raste me Infeksione Seksualisht të Transmetueshme. Rastet e raportuara janë nga komunat: Ferizaj 13, Prishtinë 6, Prizren 3, Gjakovë 2, Rahovec 2, Hani i Elezit 1, Lipjan 1 dhe Suha rekë 1. Sipas diagnozës: Chlamydia 17 raste, Condyloma 7, Gonorrhoeae 3 dhe Sifilis 2 raste. Sipas gjinisë: 18 raste i takojnë gjinisë femërore dhe 11 raste gjinisë mashkullore. Grup moshës: 25-49 vjeç i takojnë 24 raste, grup moshës 15-24 vjeç 3 raste dhe dy raste mbi 50 vjeç.

### **Hepatiti akut B dhe Hepatiti akut C, gusht 2025**

Gjatë muajit gusht, 2025, është raportuar 1 rast me Hepatit akut B nga komuna e Prishtinës (72 vjeç) i gjinisë mashkullore. Me Hepatit akut C, gjatë kësaj periudhe është raportuar një rast nga Peja (66 vjeç) e gjinisë femërore.

# Rastet e sëmundjeve ngjitëse në Kosovë sipas komunave, gusht 2025

Tabela 2.

Annex 1. Rastet e sëmundjeve ngjitëse sipas komunave Gusht 2025

SËMUNDJA KOMUNA	Sindroma meningjeale										Morbilli	Pertusia	Hepatit ac. B	Hepatit ac. C	Helmintet me ushqim	Gastroenterokolit	Brucelloza	Tularimi	Salmonelloza	Rotavirus	Borelioza (Lyme Disease)	Adenovirus	Enterovirus	Leishmaniaza	Toxoplazmoza	Entamoeba histolytica	Clidifficile	IST	HIV	TB	Giardia	Infekcionet streptokokale të gr. A	Sëm. tjera ngjitëse	Totali
	Pneumonia/ARI	SARI	ILI	Diarriae	Variçella	RSV	COVID-19	Meningjitet serosa	Meningjitet purulent	Meningjocenspet halit ac.																								
DECAN	1	0	27	314										22	1																1	366		
DRAGASH	2		9	335	1									2																1	350			
DRENAS	32	1	27	110										5																	185			
F. KOSOVË	25	2	19	58			3							1	10									1						122				
FERIZAJ	6		263	522	9		2	1	1	1				29														13	1	854				
GJAKOVË	5		156	324	3		3	1						13						2								2	8	5	496			
GJILAN	7	2	131	840	6																									3	980			
GRAGAËNICË																															1	1		
H. TELEZIT	4		33	67	0																											106		
ISTOG	4	1	100	176										4	1																3	291		
JUNIK	0	0	6	59										19																		84		
KAÇANIK	5		79	259	2									6																	1	344		
KAMENICË	0		276	671	0																											940		
KLINË	21	0	56	133	2																											212		
KLLOKOT																																0		
LEPOSAVIQ																																0		
LIPJAN	1		9	158										1	4																	182		
MALISHEVË		4	39	169	1									5	7																	226		
MAMUSHË	0		73	191	0																											273		
MITROVICË	27	1	417	1459	6	1		1	2																							1934		
MITROVICË E VERIUT																																0		
N. BËRDË	0		23	18	0																												42	
OBILIQ			16	194	2																												214	
PARTESH																																0		
PEJË	23	0	631	1455	13			3	1					13		1																2145		
PODUJEVË	53	2	152	296	6																											524		
PRISHTINË	353	6	952	2896	39			21	2					45	34	1																4412		
PRIZREN	18		338	2867	25									55																		3310		
RAHOVEC			42	252	2																												301	
RANILUG																																	0	
SHTËRPECË																																	0	
SHTIME	15		242	216	1									7	3																	486		
SKËNDERAJ	0		81	353	10																												444	
SUHAREKË	4	1	640	1607	39																												2295	
VITI	0	1	79	271	1																												353	
VUSHTRRI	3	1	77	501	3																												763	
Z. POTOK																																	0	
ZVEÇAN																																	0	
BURGU ILIPJANIT																																	0	
PA ADRESË																																	1	
TOTALI	609	22	4954	16790	180	1	39	10	1	5	5	2	1	1	394	114	4	1	11	27	3	12	5	1	1	1	2	29	3	25	8	12	81	23254

\*Sëmundjet tjera ngjitëse: Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza

### 3. RASTET E SPITALIZUARA NË KLINIKËN INFEKTIVE, PEDIATRISË DHE SPITALET E PËRGJITHSHME, GUSHT 2025

Rastet e spitalizuara nga sëmundjet ngjitëse në numër më të madh janë raportuar nga diaretë akute dhe gastroenterokolitet nga të cilat vetëm disa kanë konfirmim laboratorik të shkaktarit pasuar nga exanthemat, pneumonitë, infeksionet virale të traktit respiratorë, të cilat raportohen sipas diagnozës klinike. (shih Tabela 3).

**Tabela 3. Rastet e spitalizuara me sëmundje ngjitëse në Klinikën Infektive, Pediatriisë dhe spitalet e përgjithshme, gusht 2025**

Sëmundja	Rastet
Pneumonia /ARI	67
SARI	22
Hepatitis B	1
Sindroma meningjeale	16
Helmimet me ushqim	44
Diarea akute dhe gastroenterocolite	518
Status febrilis	17
Exanthema	88
Mononucleosis	4
Erysipela	9
Vulnus morsum viperi	7
<b>Total</b>	<b>793</b>

### 4. EPIDEMITË E RAPORTUARA GJATË MUAJIT GUSHT 2025

Gjatë muajit gusht nuk është raportuar asnjë epidemi

## 5. NIVELI I RAPORTIMIT NGA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE

Për këtë periudhë, kanë raportuar 29 komuna ose 76.31% (29/38) e tyre. Komunitat të cilat nuk kanë raportuar: Graçanicë, Kllokot, Leposaviq, Mitrovicë e veriut, Partesh, Ranillug, Shtërpce, Zveçan dhe Z.Potok.

**Tabela 4. Raportimi i sëmundjeve ngjitëse nga institucionet shëndetësore përmes SMSN, gusht 2025**

KOMUNA	KOPJE FIZIKE										SMSN										
	Spitali i përgjithshëm	Klinika Infektive (Hosp)	Klinika e Pediatrisë (amb.)	Klinika e Pediatrisë (Hosp.)	Klinika e Dermatovenerologjisë	Klinika e Pulmologjisë	QKMF	QMF	AMF	Gjithsej	Spitali i përgjithshëm	Klinika Infektive	Klinika e Pediatrisë	Klinika e Dermatovenerologjisë	Klinika e Pulmologjisë	Institucionei Private	QKTGJ	QKMF	QMF	AMF	Gjithsej
DEÇAN							265			265								77	0	0	77
DRAGASH							335			335								12	0	0	12
DRENAS							88	63		151								26	0	0	26
F.KOSOVË										0								141	0	0	141
FERRAJ	11						768			779	4							21	67	0	92
GIAKOVË	12									12	97					9		230	150	0	484
GJILAN	13						848			861								72	54	0	126
GRAÇANICË							0			0								0	0	0	0
H.VELEZIT							80			80								24	0	0	24
ISTOG							243			243								38	0	0	38
JUNIK										0								93	0	0	93
KACANIK							317			317								19	0	0	19
KAMENICË							929			929								19	0	0	19
KLINË							204			204								6	0	0	6
KLLOKOT							0			0								0	0	0	0
LEPOSAVIQ							0			0								0	0	0	0
LIPJAN										0								173	1	0	174
MALISHEVË							17			17					1			192	12	0	205
MAMUSHË							106			106								167	0	0	167
MITROVICË	157						1739			1916								3	0	0	3
MITROVICË V.							0			0								0	0	0	0
N.BËRDË							38			38								3	0	0	3
OBILIQ										0								134	19	0	153
PARTESH							0			0								0	0	0	0
PEJË	19						2052			2071	67							51	0	0	118
PODUEVË							346	11	9	366								58	51	0	109
PRISHTINË		183	866	176	0	0		605		1830		78	25	3	1	11	5	2541	119	0	2783
PRIZREN	55						2562			2617	210							243	220	0	673
RAHOVËC										0					15			151	104	29	299
RANILLUG							0			0								0	0	0	0
SHTËRPCE							0			0								0	0	0	0
SHTIMË							418			418								0	0	0	0
SKËNDERAJ							243			243								198	0	0	198
SUHAREKË							2290			2290								0	0	0	0
VITI							55			55								235	64	0	299
VUSHTRRI							424			424	111							160	65	0	336
Z.POTOK							0			0								0	0	0	0
ZVEÇAN							0			0								0	0	0	0
Gjithsej	267	183	866	176	0	0	14387	679	9	16567	489	78	25	3	1	36	5	5087	934	29	6687

Gjatë muajit gusht 2025, përmes SMSN janë raportuar gjithsej 6,687 raste me sëmundje ngjitëse. Ky numër krahasuar me numrin e rasteve të raportuara me kopje fizike shënon një rritje prej 28.75 % të rasteve të raportuara përmes SMSN. (Tabela 4).


## 6. COVID-19

Gjatë muajit gusht 2025 janë testuar gjithsej 325 mostra të dyshimta për COVID-19, prej të cilave janë konfirmuar 39 raste pozitive me SARS-CoV-2, me një shkallë pozitiviteti prej 12%. Krahasuar me muajin gusht 2024 (1,416 raste pozitive), vërehet një ulje e ulje të konsiderueshme prej 97.2%. Gjatë këtij muaji nuk është raportuar asnjë rast vdekjes me COVID-19

Nga 39 rastet e raportuara, sipas komunave: Prishtinë (21 raste), me nga 3 raste: Pejë, Gjakovë dhe Fushë Kosovë, me nga 2 raste komunitat: Ferizaj, Kamenicë dhe Shtime dhe me nga 1 rast: Mitrovicë, Suharekë dhe Istog.

Sipas gjinisë: 25 raste (64%), të gjinisë femërore krahasuar me meshkujt me 14 raste (36%). Sipas grup-moshës: 0–9 vjeç me 11 raste, 20–29 vjeç me 9 raste, grupmosha 10–19 vjeç dhe 60–69 vjeç me nga 5 raste, 50–59 me 4 raste, 30–39 dhe 40–49 vjeç me nga 2 dhe 80+, një rast.

**Grafikoni 1. Numri i rasteve të testuara, të konfirmuara me COVID-19, gusht 2025**



## 7. SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME SËMUNDJE NGJITËSE NË RAJON DHE BOTË, GUSHT 2025

### Situata epidemiologjike e Infeksioneve respiratore në BE/ZEE

Gjatë muajit gusht 2025, të dhënat e raportuara nga vendet e BE/ZEE treguan se aktiviteti i infeksioneve respiratore mbeti në nivele bazë në të gjitha vendet raportuese. Kjo tendencë e ulët ishte e qëndrueshme si në kujdesin parësor (ILI – sëmundja e ngajshme me gripin / ARI – infeksione akute respiratore), ashtu edhe në kujdesin dytësor (SARI – infeksione respiratore akute të rënda). Pozitiviteti i përgjithshëm i testeve për SARS-CoV-2 në mostra nga kujdesi parësor arriti në 21%, me variabilitet midis vendeve. Në kujdesin dytësor, për mostrat SARI, pozitiviteti ra në 11%, me rënien më të dukshme të nxitur nga të dhënat e Irlandës dhe Spanjës. Numri i shtrimeve në spital dhe i vdekjeve të raportuara mbetet relativisht i ulët. Nga mostrat jo-sentinel (të marra nga burime të përziera si kujdesi parësor, laboratorë të tjerë dhe spitale), vihet re një rritje e vazhdueshme e pozitivitetit të testeve dhe e rasteve pozitive për SARS-CoV-2 në disa vende dhe në të gjitha grupmoshat. Që nga java 20, janë vërejtur rritje të shtrimeve në spital në Irlandë, Letoni dhe Poloni, me nivele të ngjashme me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Po ashtu, në Portugali, që nga java 20, janë vërejtur rritje të vdekjeve të konfirmuara laboratorikisht nga COVID-19. Aktiviteti i gripit ka mbetur i ulët në shumicën e vendeve raportuese. Kjo tendencë reflektohet si në të dhënat sentinel, ashtu edhe në ato jo-sentinel, me një pozitivitet total prej 2.3% në mostra të kujdesit parësor dhe SARI. Sa i përket situatës aktuale me Covid-19 dhe varianteve qarkulluese, që nga përditësimi i fundit, nuk ka pasur ndryshime në listën e ECDC-së për variantet e interesit (VOI – *Variants of Interest*) apo variantet nën monitorim (VUM – *Variants Under Monitoring*). Proporcionet mesatare të variantëve në vendet e BE/ZEE, bazuar në të dhëna të raportuara nga vetëm katër shtete për javët 32–33, janë si më poshtë:

- VOI – Variant në interes:
  - BA.2.86: 5.3% (me varg: 0.0% – 8.3%)
- VUM – Variante nën monitorim:
  - LP.8.1: 4.4% (me varg: 0.0% – 41.7%)
  - NB.1.8.1: 6.8% (me varg: 0.0% – 38.5%)
  - XFG: 71.6% (me varg: 0.0% – 89.5%)

### Mbikëqyrja e virusit Chikungunya në Evropë

Gjatë muajit gusht 2025, sëmundja e shkaktuar nga virusi Chikungunya ka shënuar disa raste të importuara dhe autoktone në dy vende evropiane: Francë dhe Itali. Franca ka raportuar një shpërthim me gjithsej 111 raste, të shpërndara në 22 klasterë të ndryshëm, prej të cilëve 16 mbeten ende aktivë. Vetëm gjatë javës së fundit janë konfirmuar 48 raste të reja dhe janë identifikuar gjashtë vatra të reja infeksioni. Disa prej këtyre rasteve janë regjistruar për herë të parë në rajonet Charente, Côte-d'Or dhe Haute-Corse, ndërsa vatrat e reja janë zbuluar në Alpes-Maritime dhe Isère. Klasteri më i madh deri më tani ndodhet në Vitrolles (Bouches-du-Rhône), i cili ka arritur në 23 raste, duke pësuar një rritje të ndjeshme prej 20 rastesh krahasuar me javët paraprake. Italia, nga ana tjetër, ka raportuar një situatë më të kufizuar, me gjithsej shtatë raste për këtë vit. Zhvillimet e fundit në Francë dhe Itali tregojnë se kushtet për transmetim ekzistojnë dhe se vendet ku *Ae. albopictus* është e përhapur në mënyrë të qëndrueshme – si Franca, Italia, Spanja, Greqia, por edhe disa zona të Gjermanisë dhe Evropës Qendrore – mbeten në rrezik për shpërthime të mëtejshme.

### Shpërthimi i *Salmonella* Strathcona ST2559 në vendet e BE/ZEE dhe Mbretërinë e Bashkuar

Gjatë muajit gusht, është vërejtur një shpërthim i *Salmonella enterica* serotipi Strathcona ST2559 në vendet e BE/ZEE dhe Mbretërinë e Bashkuar. Deri më tani janë konfirmuar gjithsej 289 raste, të shpërndara në 16 vende të BE/ZEE: Austria (59),

Kroacia (3), Çekia (11), Danimarka (10), Estonia (1), Gjermania (68), Finlanda (3), Franca (24), Irlanda (3), Italia (78), Luksemburgu (2), Holanda (4), Norvegjia (4), Sllovakia (5), Sllovenia (8) dhe Suedia (6). Jashtë BE/ZEE, rastet janë raportuar në Mbretërinë e Bashkuar (29), SHBA (8) dhe Kanada (5). Rastet e lidhura me udhëtime janë identifikuar në disa vende, ku Italia është vendi më i shpeshtë i përmendur si destinacion udhëtimit nga personat e infektuar. Hetimet e kryera në Austri (2023) dhe Itali (2024), kanë konfirmuar se domatet e vogla nga rajoni i Sicilisë në Itali ishin burimi i infeksionit në këto raste. Ky përfundim është në përputhje me shpërthimin historik të ngjashëm në Danimarkë në vitin 2011. Analizat e sekuencimit të të gjithë gjenomit (WGS) kanë treguar se izolatet nga vendet e prekura ndajnë një origjinë të përbashkët të afërt. Nga qershori deri më 4 shtator 2025, 29 raste të reja të konfirmuara janë raportuar në nëntë vende: Italia (11 raste, përfshirë një klaster rajonal), Austria (5 raste, kryesisht në Austrinë e Epërme), Gjermania (6 raste, shumica pa histori udhëtimit), Irlanda (2), Norvegjia (1), Danimarka (1), Franca (1), Çekia (1) dhe Holanda (1). Katër raste nga këto vende kishin histori udhëtimit në Itali.

Ekspozimi ndaj domateve është raportuar nga katër raste në Itali, megjithëse të dhënat e ekspozimit mbeten të kufizuara. Për më tepër, 23 raste të tjera janë në pritje të rezultateve të sekuencimit në Austri, Itali dhe Çeki.

### **Mbikëqyrja epidemiologjike sezonale e infeksionit me virusin e West Nile (Ethet e Nilit perëndimor)**

Gjatë muajit gusht, deri më 3 shtator, në Evropë janë raportuar 652 raste të infeksioneve me virusin West Nile (WNV) (Ethet e Nilit perëndimor), që janë marrë lokal, në nëntë vende të ndryshme me vendin e infektimit të njohur. Data e para e fillimit të simptomave ishte më 2 qershor, ndërsa më e fundit më 31 gusht. Nga këto raste, Italia raportoi numrin më të madh prej 500 infeksionesh, me 32 vdekje, duke përfaqësuar një shkallë fataliteti prej 6.4%, e cila është brenda parametrave të pritur për këtë virus. Përveç Italisë, raste u raportuan edhe në Greqi (69 raste, përfshirë një rast me vend infektimi të panjohur), Serbi (33 raste), Francë (20 raste), Rumani (15 raste), Hungari (6 raste), Spanjë (5 raste), Shqipëri (3 raste) dhe Bullgari (1 rast). Numri i përgjithshëm i vdekjeve në Evropë ishte 38. Numri i rasteve të raportuara këtë vit tejkalon mesataren e dhjetë viteve të fundit për të njëjtën periudhë kohore, që është 514 raste, megjithatë, mbetet më i ulët se numri i rasteve të regjistruara në vitet 2018, 2022 dhe 2024, kur përqendrimi i virusit ishte jashtëzakonisht i lartë dhe numri i rasteve tejkaloi 1000 deri në këtë periudhë të vitit. Italia aktualisht po përjeton një shpërthim të madh të virusit, me numrin më të lartë të rasteve të raportuara për këtë periudhë të vitit në historinë e saj, ku raste të shumta vijnë nga rajoni i Lazio, veçanërisht nga provincat Latina, Roma dhe Frosinone, që së bashku përbëjnë 218 raste, dhe nga rajoni i Kampanisë, me 106 raste të raportuara në qytetet Napoli, Caserta, Salerno dhe Avellino. Rajonet e tjera raportojnë nivele të ngjashme me ato të viteve të mëparshme. Nga pikëpamja gjeografike, raste njerëzore të infeksionit me WNV janë regjistruar në 100 rajone në nëntë vende, krahasuar me 174 rajone në 16 vende në të njëjtën periudhë të vitit 2024 dhe 129 rajone në 12 vende në vitin 2018, duke treguar një përhapje të qëndrueshme dhe ekspansion gradual të virusit në Evropë. Për më tepër, gjatë këtij sezoni transmetues janë regjistruar raste njerëzore për herë të parë në disa rajone të Italisë, përfshirë Genova, Sondrio, Palermo dhe rajone të tjera, si dhe në disa zona të Francës dhe Rumani, që tregojnë një zgjerim të mëtejshëm gjeografik të virusit. Sa i përket profilit demografik dhe klinik të rasteve, si në vitet e mëparshme, shumica e rasteve janë tek meshkujt mbi moshën 65 vjeç. Norma e hospitalizimeve mbetet shumë e lartë në 91%, në përputhje me vitet e kaluara (92%), duke reflektuar faktin se sistemi i mbikëqyrjes së WNV fokusohet kryesisht në rastet më të rënda klinike, duke përfshirë ato me manifestime neurologjike, të cilat janë raportuar në 54% të rasteve këtë vit, pak më ulët se mesatarja e 67% të dekadës së kaluar. Norma e fatalitetit prej 6% është gjithashtu më e ulët krahasuar me 11% e dekadës së fundit, duke treguar një pakësim të lehtë të rrezikut të vdekshmërisë, por ende duke reflektuar rëndësinë klinike të virusit.

### **Listerioza në shumë vende të BE dhe ZEE**

Në Francë u raportua një shpërthim i *Listeria monocytogenes* më 30 korrik 2025. Gjatë muajit gusht 2025, Franca ka raportuar 21 raste që nga dhjetori 2024, përfshirë 18 raste që nga qershori 2025. Janë regjistruar dy vdekje. Rastet i takojnë grup-moshës 34 deri 95 vjeç, 11 prej tyre të gjinisë femërore. Hetimet epidemiologjike dhe mikrobiologjike në Francë lidhen

shpërthimin me një prodhues francez të djathit të butë nga qumështi i lopës dhe i dhisë, i pasterizuar. Katër vende të tjera – Belgjika, Danimarka, Holanda dhe Norvegjia – raportuan nga një rast të konfirmuar (të gjitha rastet i përkasin grup-moshës 35–70 vjeç), të ndodhura midis 14 prillit dhe 9 korrikut 2025. Të prekurit nga Belgjika, Danimarka dhe Holanda kishin konsumuar djath të butë të pasterizuar. Hetimet për gjurmimin e produktit janë ende në vazhdim. Produktet janë shpërndarë në Shqipëri, Andorrë, Australi, Austri, Belgjikë, Burkina Faso, Kamboxhia, Kanada, Çeki, Bregun e Fildishtë, Danimarkë, Estoni, Finlandë, Francë (përfshirë Polinezinë Franceze), Gjermani, Hong Kong (Kinë), Hungari, Itali, Japoni, Madagaskar, Malajzi, Mauricius, Holandë, Kaledoni e Re, Singapor, Sllovakia, Kore Jugore, Spanjë, Suedi, Zvicër, Mbretëria e Bashkuar dhe SHBA.

Për të mbrojtur konsumatorët, produktet janë tërhequr nga tregu dhe autoritetet kombëtare të sigurisë ushqimore po zbatojnë masa kontrolli dhe paralajmërime publike.

Shtami i *L. monocytogenes* i lidhur me shpërthimin i përket grupit L1-SL387-ST388-CT22724, genosero-grupe PCR IVb. Deri më 13 gusht 2025, Austria, Finlanda, Gjermania, Irlanda, Italia, Portugalia, Spanja, Suedia, Zvicra dhe Mbretëria e Bashkuar nuk kanë raportuar raste të lidhura.

### **Mbikëqyrja sezonale e Etheve Hemorragjike Krime-Kongo (CCHF)**

Gjatë muajit gusht, dy vende të Evropës kanë raportuar raste të Etheve Hemorragjike Krime-Kongo (EHKK): Spanja (3 raste) dhe Greqia (2 raste). Këtë javë nuk janë raportuar raste të reja në ECDC. Rastet në Greqi, të ndodhura në rajonin e Thessalisë, janë të paparashikuara, pasi ky rajon dhe rajonet përreth nuk kishin raportuar më parë raste me EHKK. Rasti i parë është infektuar nga një pickim i rriqerës, ndërsa rasti i dytë ishte një punonjës shëndetësor që kujdesej për pacientin e pickuar. Këto janë rastet e para në vend që nga viti 2008, kur u raportua rasti i vetëm autokton në rajonin e Thrakisë (në kufi me Bullgarinë). Në Spanjë janë regjistruar gjithsej 16 raste autoktone, kryesisht midis prillit dhe gushtit. Provinca Salamanca konsiderohet një zonë endemike, ku 50% e rasteve kanë qenë të ekspozuar ndaj pickimeve nga rriqërat.

### **Raste autoktone të Malaries në Mayotte, Francë – 2025**

Në Francë, në Mayotte, janë raportuar gjithsej 66 raste me malarie: 12 raste autoktone (1 në shkurt, 1 në qershor dhe 10 në korrik) dhe 54 raste të importuara, kryesisht nga Bashkimi i Komoreve (83%). Në 26 raste (39%) ishte i nevojshëm hospitalizimi, përfshirë 5 raste në njësinë e kujdesit intensiv; nuk u regjistrua asnjë vdekje. Të gjitha rastet ishin shkaktuar nga *Plasmodium falciparum*. Numri i rasteve të importuara ka pasur një rritje graduale gjatë pesë viteve të fundit, me një kulm në 2024 (119 raste importuara). Hetimet për lidhshmëri epidemiologjike dhe burimin e infeksionit vazhdojnë, ndërsa autoritetet shëndetësore po zbatojnë masa të gjera kontrolli të mushkonjave. Rreziku i infeksionit mbetet i ulët dhe nuk rrit mundësinë e rasteve autoktone në Evropën kontinentale. Udhëtarët në Mayotte rekomandohen të përdorin masa mbrojtëse kundër pickimit të mushkonjave, dhe çdo person me simptoma pas udhëtimit në zonë endemike duhet të konsiderojë diagnostikimin e malaries dhe të kryejë test biologjik konfirmues.

### **Mbikëqyrja sezonale e etheve të dengës – 2025**

Gjatë muajit gusht, deri më 3 shtator, në Evropë janë raportuar 25 raste të dengës me transmetim lokal nga tre vende: Franca (19 raste), Italia (4 raste) dhe Portugalia (2 raste). Franca vazhdon të raportojë rritje të rasteve me transmetim autokton, me pesë raste të reja gjatë javës së fundit në klasterë të rinj në Aubange dhe Beaulieu, si dhe një rast shtesë në klasterin ekzistues në Langon. Deri tani, në Francë janë identifikuar 10 klasterë në total, nga të cilët 6 mbeten aktivë. Italia ka raportuar katër raste autoktone në dy klastra, me një klaster aktiv në Brendola. Një rast i dyshuar është përjashtuar, pasi nuk kishte lidhje me ndonjë klaster apo zonë specifike (LAU). Portugalia ka raportuar dy raste, por asnjë rast i ri nuk është njoftuar gjatë javës së fundit.

## **8. REKOMANDIMET**

Për ngritjen e kualitetit të raportimit, mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse dhe aplikimin e masave parandaluese dhe kundërepidemike në kohë rekomandojmë:

Bazuar në Ligjin për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse Nr.08/L-200, Neni 20 dhe 21 të gjitha Institucionet shëndetësore obligohen të raportojnë në IKSHPK/QRSHP sipas listës së sëmundjeve ngjitëse Aneksi 1 i këtij ligji.

Raportimi i sëmundjeve të bëhet përmes sistemit të digjitalizuar të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse në të gjitha nivelet me qëllim të sigurimit të të dhënave në kohë reale, të dhëna kualitative dhe pasqyrë reale të situatës epidemiologjike për parandalim dhe kontrollë të sëmundjes.

---

***INSITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË***

***PUBLIKE TË KOSOVËS***

***Departamenti i Epidemiologjisë***

***Adresa: Rruga Instituti Shëndetësor Nr. 12, Prishtinë 10000***

***WebFaqe: <http://www.niph-rks.org>***

***E-mail: [QOE.IKSHP@rks-gov.net](mailto:QOE.IKSHP@rks-gov.net)***

***Telefoni+38338 541432***

---